



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 44, datë 17.03.2021

PËR

MIRATIMIN E SHTYRJES SË AFATIT DHE NDRYSHIMEVE NË PROJEKT GJATË  
NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “NDËRTIMI HIDROCENTRALEVE “BACKA 1, BACKA  
A, BACKA C”, ME VENDNDODHJE NË BASHKINË SKRAPAR

Në mbështetje të neneve 27, 28, 40 dhe 48 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; nenit 17, të Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “Kroi Mbret Energji” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e shtyrjes së afatit dhe ndryshimeve në projekt gjatë ndërtimit për objektin: “Ndërtimi hidrocentraleve “Backa 1, Backa A, Backa C”, me vendndodhje në Bashkinë Skrapar, me subjekt zhvillues shoqërinë “Kroi Mbret Energji” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave, miratuar me vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 5 datë 22.07.2015 zëvendësohet me Hartën e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

**BELINDA BALLUKU**



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

**LEDIA TOJA**

